



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

Kodi: 014

**KEC**

## **HAP PAS HAPI**

Trajnimi për klasën e katërt

### Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve të përgjithshme filozofike* dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si genie intelektuale, sociale dhe emocionale
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*
- Aftësi për *organizimin e mësimit kooperativ* që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm
- Aftësi për *planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimit tematik* me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë*
- Aftësi për *aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies* në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore

- Ide për krijimin e një *ambienti stimulus për mësimnxënie aktive*
- Njohuri për *përfshirjen e familjes* në realizimin e programit

### Përmbajtja e trajnimit

Metodologjia Hap pas Hapi në klasën e katërt, përshtatja ndaj stileve të ndryshme të mësimnxënies në klasë, mësimi me tema që përfshijnë grup lëndësh, menaxhimi i klasës, komunikimi I, komunikimi II, strategji mësimdhënieje që nxisin motivimin për të lexuar, teknika dhe strategji që nxisin aftësitë e të shkruarit tek nxënësit, matematikë, shkencë, edukimi shoqëror, teknika për të qenë mësues i suksesshëm.

### Grupi i synuar

Ky program u dedikohet mësuesve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

### Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimet për shkollë fillore realizohen në kontinuitet për katër vitet akademike në ciklin e ulët të shkollës fillore. Trajnimet mbështesin objektivat e njehta të programit HpH, porse veçojnë karakteristikat e moshës së fëmijëve, si dhe veçantitë e programit të shkollës për nivele të ndryshme. Ato thellojnë njohuritë për problemet e trajtuara në fjalë si dhe zgjerojnë njohuritë për teknika dhe forma të reja të mësimdhënies gjatë procesit mësimor.

Trajnimi për klasën e katërt realizohet brenda tri ditëve me gjithsej 24 orë trajnim dhe pasohet me 4 punëtori njëditore gjatë një viti.

Me qëllim që të përcillet puna në kontinuitet dhe të punohet sa më shumë në cilësi të punës çdo muaj parashihen monitorime në klasë.

### Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim.